



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./v.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsioni, duke vepruar në rastin e formuar pas kërkesës së paraqitur nga parashtruesi i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme KSHPK), në seancën e 73-të të mbajtur më 18.08.2022 ka miratuar si në vijim.

VENDIM

Denoncimi i regjistruar sipas nr. 12-7276/1 të 23.12.2021, kundër njësisë ligjore - ordinancës stomatologjike Dr. ----- të Manastirit, **HIDHET POSHTË.**

KSHPK përcaktoi se sipas Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin e lëndës, ndërsa organet tjera kompetente tashmë kanë vepruar sipas pretendimeve.

Lënda me numër 12-7276 të vitit 2021 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Nga një parashtrues i njohur, -----, më 23.12.2021, është dorëzuar denoncim kundër personave juridik, ordinancës stomatologjike Dr.----- nga ----- dhe u formua lënda me numër 12-7079 të vitit 2021.

Në denoncim parashtruesi thekson se është i pakënaqur nga leja e dhënë për punë të Institucionit të përmendur shëndetësorë në ----- për arsye se e njëjta gjendej në një pjesë të shtëpisë së saj.

Parashtruesi tashmë është drejtuar disa institucioneve si: Odës Stomatologjike, Komunës së Manastirit, Inspektoratin Shtetëror për Ndërtimtari dhe Urbanizëm, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Inspektoratin Shëndetësor Sanitar Shtetëror, nga ku ka marrë njoftime individuale se institucionet janë jo kompetente ose gjatë mbikëqyrjes së jashtëzakonshme nuk janë konstatuar parregullsi në kryerjen e shërbimeve të ordinancës stomatologjike të përmendur.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në lëndë , KSHPK-ja konstaton se në rastin bëhet fjalë për pretendime që nuk i nënshtrohen veprimet të saj kompetent, por bëhet fjalë për pretendime që kanë të bëjnë me veprimin kompetent të një organi tjetër kompetent, të cilët tashmë kanë vepruar sipas pretendimeve, pas së cilës ka vlerësuar se nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin në fjalë.

Në bazë të lartpërmendurës, KSHPK-ja vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

Dorëzuar deri te:

Parashtruesi i denoncimit

Përgatiti: Mr. K.Z.

Miratoi: Mr. SH.S, Anëtar i KSHPK-së

KOMISIONI SHTETËRORE
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT
Kryetare,
Biljana Ivanovska
